



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KWSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____, 2019

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 994, DATË 9.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS NË PRONËSI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, dhe të neneve 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "b" e pikës 1, riformulohet, si më poshtë vijon:

"b) Identifikimin e organit që e ka lëshuar AMTP-në, që përfaqësohet nga firma ose emër mbiemër me shkrim dore i kryetarit të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, për aktet e lëshuara deri në 15.8.2008, ose nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, për AMTP-të e lëshuara në zbatim të ligjeve nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, ligjit nr. 57/2012 "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore" dhe ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar.

Do të konsiderohen të pranueshme edhe AMTP-të në të cilat mungon firma ose nënshkrimi i kryetarit të Komisionit të ndarjes së tokës në fshat, por që në bazë të dokumentacionit të lëshuar nga DAMT vërtetohet lëshimi i AMTP-së.

Në rast se në një AMTP janë të pasqyruara emrat e të gjithë anëtarëve të Komisionit të ndarjes së tokës në fshat, konsiderohet i identifikuar organi që e ka lëshuar AMTP-në edhe nëse nuk është pasqyruar nënshkrimi i kryetarit, por kanë nënshkruar shumica e anëtarëve të komisionit."

2. Shkronja "b" e pikës 2.2, riformulohet, si më poshtë vijon:

"b) Kur gjatë verifikimit rezulton se AMTP me anë të cilës është kryer regjistrimi ka mangësi, konstatimet e kryera nga punonjësit që përpunojnë praktikat i referohen regjistruarit me shkrim duke treguar hollësisht mangësitë e konstatuara.

Regjistrimi në origjinë (fillestar) i tokës bujqësore me AMTP është me mangësi në rastet:

i) Kur në AMTP mungon një apo më shumë elementë të përcaktuara në pikën I, të këtij vendimi.

ii) AMTP është me korrigjime tek shënimi pronësi dhe përdorim (në rastet kur AMTP është lëshuar për territoret e ish-NB-ve), tek numri i ngastrës, ose tek sipërfaqja dhe emërtimi i ngastrës. Nuk do të konsiderohen mangësi rastet kur në ZVRPP është i depozituar dokumenti i fitimit të pronësisë mbi tokën bujqësore (AMTP) për territoret e ish kooperativave bujqësore dhe në të konstatohet se fjala "NË PRONËSI" është shkruar me shkrim dore mbi fjalën "NË PËRDORIM", të fshirë me vizë. Mbi këtë fjalë mund të gjendet edhe nënshkrimi dhe vula zyrtare e ish komunës. Gjithashtu dokumentacioni i pronësisë të fshatit të depozituar në ZVRPP, duhet të jetë i shoqëruar edhe me deklarin e anëtarëve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, se ky veprim është bërë në mungesë të formularëve të pronësisë. Në këto raste ZVRPP i drejtohet zyrtarisht bashkisë që të konfirmojë nëse AMTP është lëshuar nga ajo. Bashkia, pas verifikimit të dokumentacionit që disponon dhe pas verifikimit faktik të tokës bujqësore që zotërohet nga familja bujqësore i përgjigjet zyrtarisht ZVRPP-së. Ky konfirmim dërguar me shkresë zyrtare nga bashkia, nuk ka të bëjë me konfirmimin e përmbajtjes së AMTP-së.

iii) AMTP nuk administrohet në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe administrohet fotokopje, fotokopje e noterizuar apo dublikatë.

iv) Konsiderohen të rregullta AMTP-të e lëshuara nga komisionet e ndarjes së tokës përpara datës 15.8.2008, që janë të shoqëruara me më tepër se një certifikatë të përbërjes familjare, në të njëjtin fshat, në datën 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, dhe në datën 1.8.1991 për ish-ndërmarrjet bujqësore, duke llogaritur ndryshimet në numrin e pjesëtarëve të saj deri më 1.10.1992, fakt ky i pranuar nga përfituesit me deklarin noterial se nuk janë trajtuar me AMTP tjetër, duke i konsideruar si një familje bujqësore me 2 certifikata të përbërjes familjare. Në këtë rast bashkia, pas verifikimeve që bëhen në dokumentacionin që disponon dhe pas verifikimit faktik të tokës bujqësore që zotërohet nga familja bujqësore, duhet të konfirmojë këtë fakt zyrtarisht, konfirmim i cili nuk ka të bëjë me konfirmimin e përmbajtjes së AMTP-së. Shkresa së bashku me dokumentacionin e fitimit pronësisë, deklarin noterial dhe certifikatat e gjendjes civile depozitohen në ZVRPP nga bashkia sipas përcaktimit në germen "c".

3. Në paragrafin e dytë të shkronjës "ç", të pikës 2.2, shtohet shprehja:

"Formati i AMTP-së është sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM NR. 994, DATË 09.12.2015 “PËR REGJISTRIMIN E AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI” TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i hartimit të këtij projektvendimi është të lehtësojë dhe qartësojë procedurat që lidhen me procesin e regjistrimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, me aktin e marrjes së tokës në pronësi, në vijim të AMTP-ës, të nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, nga organet e pushtetit vendor në bashkëveprim me zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Ky projektvendim është hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është hartuar në përputhje me programin e qeverisë, në të cilin toka bujqësore dhe titujt e pronësisë mbi të janë nga prioritetet e saj për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe veçanërisht për konsolidimin dhe sigurinë juridike të këtyre titujve. Për arritjen e këtij objekti, si pjesë e një pakete masash ku përfshihen plotësimi i titujve të pronësisë mbi tokën, regjistrimi i tyre në Regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisja e përfituesve me Çertifikatën e Pronësisë, me qëllim që ta përdorin tokën dhe ta hedhin në qarkullimin civil, janë të nevojshme edhe përmirësimet që i bëhen këtij vendimi.

Ky projektvendim ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave, dhe as me dokumente të tjera politike.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi, i cili vjen si bashkëpropozim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe ministrit të Drejtësisë, parashikon se regjistrimi i fitimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP), bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP), në përputhje me nenet 25 e 45 të ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", pas verifikimit nëse AMTP-ja përmban elementet e formës dhe përmbajtjes të përcaktuar në këtë projektakt.

Ky projektvendim sjellë një sërë përparësish:

1. Është saktësuar se çfarë do të konsiderohet identifikim i organit që e ka lëshuar AMTP, duke qartësuar rastet kur konsiderohet i identifikuar, pasi mënyra e të shprehurit në pikën 1 të vendimit ishte e përgjithshme, duke sjellë vështirësi në praktikë për Bashkitë.
2. Drafti i ri nuk konsideron si mangësi të AMTP-s të lëshuar në territoret e ish kooperativave, kur mbi AMTP-n e depozituar në ZVRPP kanë të fshirë me vijë "NË PËRDORIM" dhe është shënuar sipër "NË PRONËSI". Kjo pasi është i njohur si fenomen mungesa e formularëve të pronësisë nga komisionet e ndarjes së tokës. Deri më tani këto nuk regjistroheshin edhe pse në fakt qytetarët ishin subjekte përfitues të ligjshëm të tokës në pronësi.
3. Gjithashtu është zgjidhur edhe rasti i ndeshur në shumë Bashki, ku ishin përfshirë në të njëjtin titull pronësie dy certifikata familjare, duke i konsideruar një familje bujqësore. Këto mangësi, në bazë të këtyre ndryshimeve, nuk do përbëjnë shkak për mosregjistrim të titullit të pronësisë, me kushtin që përfituesit të bëjnë deklarate noteriale ku të pranojnë se nuk janë trajtuar me AMTP tjetër.
4. Gjithashtu është zgjidhur situata e atyre fshatrave të cilave u është djegur gjatë trazirave të vitit 1997 i gjithë dokumentacioni që gjendej në zyrat e regjistrimit, të tilla si Lushnje, Fier etj. Këto shqetësime janë ngritur vazhdimisht nga Bashkitë të cilat nuk pajisnin dot me AMTP qytetarët pasi ata figurojnë të trajtuar njëherë. Drafti i ri i jep mundësinë bashkisë që të plotësojë një dublikatë sipas modelit bashkëlidhur këtij projektvendimi.

AMTP edhe nëse nuk është nënshkrimi i kryetarit por kanë nënshkruar shumica e anëtarëve të Komisionit.”

Shkronja “b” e pikës 2.2, riformulohet.

- a. Për rastet kur AMTP është me korigjime tek shënimi pronësi dhe përdorim (në rastet kur AMTP është lëshuar për territoret e ish-NB-ve), tek numri i ngastrës, sipërfaqja dhe emërtimi i ngastrës. Nuk do të konsiderohen mangësi rastet kur në ZVRPP është i depozituar dokumenti i fitimit të pronësisë mbi tokën bujqësore (AMTP) për territoret e ish kooperativave bujqësore dhe në të konstatohet se fjala “NË PRONËSI” është shkruar me shkrim dore mbi fjalën “NË PËRDORIM”, të fshirë me vizë. Mbi këtë fjalë mund të gjendet edhe nënshkrimi dhe vula e ish komunës. Gjithashtu dokumentacioni i pronësisë të fshatit është depozituar në ZVRPP, i shoqëruar me deklarin e anëtarëve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, se ky veprim është bërë në mungesë të formularëve të pronësisë. Në këto raste ZVRPP i drejtohet shkresërisht bashkisë që të konfirmojë në se AMTP është lëshuar nga ajo. Bashkia, pas verifikimit të dokumentacionit që disponon dhe pas verifikimit faktik të tokës bujqësore që zotërohet nga familja bujqësore i përgjigjet me shkresë ZVRPP.
 - b. Për rastet kur konsiderohen të rregullta AMTP-të e lëshuara nga komisionet e ndarjes së tokës përpara datës 15.8.2008, që janë të shoqëruara me më tepër se një certifikatë të përbërjes familjare, në të njëjtin fshat, në datën 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, dhe në datën 1.8.1991 për ish-ndërmarrjet bujqësore, duke llogaritur ndryshimet në numrin e pjesëtarëve të saj deri më 1.10.1992, fakt i pranuar nga përfituesit me deklarin noterial se nuk janë trajtuar me AMTP tjetër, duke i konsideruar një familje bujqësore me 2 certifikata të përbërjes familjare. Në këtë rast bashkia, pas verifikimeve që bëhen në dokumentacionin që disponon dhe pas verifikimit faktik të tokës bujqësore që zotërohet nga familja bujqësore, duhet të konfirmojë këtë fakt me shkresë. Ky konfirmim nuk ka të bëjë me konfirmimin e përmbajtjes së AMTP-së. Shkresa, bashkë me dokumentacionin e fitimit pronësisë, deklarin noterial dhe Çertifikatat e gjendjes civile depozitohen në ZVRPP nga bashkia.
3. Në paragrafin e dytë të shkronjës “ç”, të pikës 2.2, shtohet fjalia “Formati i AMTP është sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi”. Modeli/formati i AMTP-së dublikatë është bazuar në modelin e AMTP-së që është përdorur edhe

më parë, por ndryshon baza ligjore dhe përfaqësuesit e organeve të qeverisjes vendore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi ZQRPP, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, Komisioni Qeveritar i Tokës, drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës pranë këshillave të qarqeve, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë dhe njësitë e qeverisjes vendore.


VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT


Projektvendimi është hartuar në bashkëpunim mes Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe ZQRPP-së dhe i është dërguar për konsultim të brendshëm Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme. Ndërkohë për përmbajtjen e projektvendimit ALUIZNI është shprehur dakord.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektvendimi nuk ka efekte financiare.

MINISTRI I DREJTËSISË


ETHILDA GJONA



MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

NIKO PELESHI